



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia org. Nr. i Prot. 52-02
Org. Jedinica Broj Prot. 6616-2 / 25
Org. Unit Prot. No.
Nr. i Fageve -05-
Br. Stranica
No. Pages
Datum: 05.02.26
Date:
PRISHTINË / A No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	19.01.2026
REFERENC-Ë:	25/6616/537/DMM
PËR/ZA/TO:	"Weng Fat Polutry" Sh.p.k. Skenderaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/6616/537/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Weng Fat Polutry" Sh.p.k. Skenderaj, Fabrikë për përpunimin e mishit të shpezëve, Polac, Skenderaj.
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelaria Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

V E N D I M

Kompania "Weng Fat Polutry" Sh.p.k. Skenderaj pajiset me Pëlqim Mjedisor për veprimtarinë: Fabrikë për përpunimin e mishit të shpezëve, Polac, Skenderaj, nën kushtet si vijon:

- Impianti të jetë në zonë të përshtatshme, larg burimeve të ndotjes dhe me qasje të mirë në infrastrukturë rrugore;
- Të bëhet ndërtimi i zonave të ndara funksionalisht: papërpunuar, përpunim, ruajtje, ndihmëse me qëllim të menaxhimit më efikas të rrjedhës së produktit dhe higjienës me qëllim të evitimit të mbetjeve dhe ujërave të ndenjura;
- Me qëllim të parandalimit të kondensimit dhe ndotjes të vendoset sistemi i ventilimit për kontrollin e lagështisë, erërave dhe temperaturës;

Faqe 2 nga 5

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: zsp.mmphi@ks-gov.net




- Të bëhet betonimi i dysHEME dhe izolimi i platos manipuluese me pjerrësi të mjaftueshme dhe kanalizim me sistem kundër kthimit të ujërave;
- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos ku janë të vendosura pajimet për përpunimin e mishit, si dhe të tëra sipërfaqet funksionale;
- Të bëhet betonimi dhe izolimi i platos së depos ku deponohen prodhimet finale, si dhe mbeturinat nga nënproduktet e krijuara gjatë procesit të prodhimit;
- Të bëhet ndarja e mbeturinave organike dhe teknike; kontenierë të mbyllur dhe të identifikuar për deponimin e mbeturinave të ngurta dhe lëngta konform kërkesave nga legjislacioni në fuqi për trajtimin e mbeturinave;
- Të sigurohet marrëveshja me operatorë të licencuar për grumbullimin dhe asgjësimin e mbeturinave të kafshëve;
- Bazuar në Ligjin e Ujrave Nr.04/L-147, neni 48, pika 1 dhe 1.3, me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: ndërtimi i objekteve tjera të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku tridhjetë (30) metra, nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve.
- Të vendoset sistemi i trajtimit të ujërave para shkarkimit në recipient (impianti për trajtimin e ujërave nga procesi teknologjik);
- Ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura në tokë, lumenj apo rrjeta kullimi pa trajtim të mëparshëm;
- Të bëhet nivelizimi, gjelbërimi i terenit dhe rregullimi i rrethojës së terenit afër fabrikës të përpunimit të mishit;
- Të bëhet plani për masat rehabilituese në rast ndotje dhe dëmtimi të mjedisit, gjatë zbatimit të projektit si dhe pas përfundimit të tij;
- Të përgatitet dhe zbatohet plani për raste të aksidenteve mjedisore bazuar në legjislacionin në fuqi;
- Aplikuesi përpos kushteve të lartë cekura të i përmbahet rekomandimeve dhe kushteve të përshkruara në raportin e VNM-së.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lart cekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dhe dokumentacionit përcjellës të dorëzuar nga Kompania "Weng Fat Polutry" Sh.p.k. Skenderaj për Fabrikën për përpunimin e mishit të shpezëve, në ngastrën Kadastrale P-72015065-00136-2 në Z.K. Polac, Skenderaj Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.



Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-181 për VNM.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

Vërejtje: Afati i paraparë për shqyrtim të lëndës është tejkaluar për shkak të ngarkesës me lëndë.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njejtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/6616/ ZSP/26 datë: 19.01.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Skenderajit
7. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
8. Divizionit për komunikim me publikun
9. Arkivit të MMPHI



Izedin Bytyqi

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI

2. SHTOJÇË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Neni 31.

Leja Mjedisore

1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithësesi para lëshimit në punë.

Neni 35.

Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

